



**FTESË PËR PJESËMARRJE ONLINE NË KURSIN E TRAJNIMIT
“CHILDREN AND YOUTH AT RISK EDUCATIONAL CHALLENGES
DURING COVID 19”**

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Izrael njofton se Qendra e Trajnimeve të Agjencisë së Bashkëpunimit për zhvillimin Ndërkombëtar të Izraelit (MASHAV), organizon kursin e trajnimit në fushën e arsimit, me temë “Children and Youth at Risk, Educational Challenges during Covid 19”, i cili do të zhvillohet *online* në datat 18 nëntor – 16 dhjetor 2020.

Kursi i ofruar nga Qendra Ndërkombëtare e Edukimit “A. Ofri MASHAV” paraqet një program të integruar e të përqëndruar në qasjet inovative pedagogjike në arsim, ide të reja praktike, rritje profesionale, praktikë dhe ekesperiencë, ekspozim ndaj mjeteve metodologjike që po përdoren në kuadër të përvojave të fituara gjatë procesit mësimor.

Pjesëmarrësit në këtë kurs duhet të jenë edukatorë, këshillues, psikologë, specialistë të edukimit dhe çështjeve sociale për zhvillimin e fëmijëve, mësues, etj.

Formulari i plotësuar i aplikimit duhet të dorëzohet me postë në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë jo më vonë se **data 20.10.2020**, që është edhe afati i fundit për aplikim.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni adresave të mëposhtme në web:

www.ofri.org.il

<http://mashav.mfa.gov.il>

<https://www.facebook.com/MASHAVisrael>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS